



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

**Nr. 2, datë 27.04.2018**

**PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,  
BASHKIA KAVAJË**

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Bashkisë Kavajë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 96, datë 19.12.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
    - iii. Ndarja e territorit në njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Kavajë,

RECEIVED  
MAY 19 1964  
SHIPPING DEPARTMENT



Shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.

3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Kavajë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Kavajë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Kavajë përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
  - Vendim Nr. 5, datë 22.12.1993 i KRRTRSH-së “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Kavajës”;
  - Vendim Nr. 6, datë 22.12.1993 i KRRTRSH-së “Mbi studimin urbanistik të zonës turistike të Golemit”;
  - Vendim Nr. 1, datë 23.08.1994 i KRRTRSH-së “Për studimin e planit rregullues të qytetit të Kavajës”;
  - Vendim Nr. 3 datë 09.05.1997 i KRRTRSH-së “Për miratimin e klasifikimit të zonës turistike të rrethit të Kavajës”;
  - Vendim Nr. 2, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për ristudimin urbanistik të zonës turistike Golem-Kavajë”;
  - Vendim Nr. 3, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për studimin urbanistik pjesor të qendrës së zonës turistike Golem-Kavajë”;
  - Vendim Nr. 7, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për studimin urbanistik për zhvillimi turistik dhe mbrojtjen e bregut të detit në Karpen-Kavajë”;
  - Vendim Nr. 12, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Kavajës dhe vijën kufizuese të kësaj qendre”;
  - Vendim Nr. 9, datë 07.05.2005 i KRRTRSH-së “Për miratimin e Masterplanit të unifikuar të zonës turistike Shkëmbi i Kavajës-Mali i Robit, Kavajë”;
  - Vendim Nr. 2, datë 21.11.2006 i KRRTRSH-së “Për miratimin e detyrës së projektimit për studimin e integruar të zonës turistike Rrashbull-Golem-Karpen”;
  - Vendim Nr. 6, datë 22.05.2007 i KRRTRSH-së “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Kavajës”;
  - Vendim Nr. 8, datë 06.07.2010 i KRRTRSH-së “Detyra e Projektimit për Planin e



- Urbanistike Pjesore në zbërthim të këtij plani, Komuna Gosë, Kavajë”;
- Vendim Nr. 1, datë 11.07.2011 i KRRTRSH-së “Detyra e projektimit të zonës urbanistike “Kalaja e Turrës” me sipërfaqe 700 ha, Komuna Synej, Qarku Tiranë”;
  - Vendim Nr. 10, datë 01.06.2012 i KKT-së “Plan i Përgjithshëm Vendor Kalaja e Turrës, Komuna Synej”;
  - Vendim Nr. 20, datë 10.05.2013 i KKT-së “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Golem”;
  - Vendim Nr. 15, datë 04.07.2013 i KKT-së “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor komuna Synej, Qarku Tiranë”.

7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.

8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DIREKTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

